

V E N D I M

Nr. 833, datë 28.12.1998

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË QEVERISË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë së qeverisë për zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e strategjisë, sipas planit të veprimit, bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË QEVERISË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI

Dhjetor 1998

PËRMBAJTJA

1. Reforma institucionale

Ristrukturimi i ndërmarrjeve të ujrave

Ristrukturimi i shërbimit pyjor

Shërbimi këshillimor

2. Problemet e tokës

Krijimi i një tregu funksional të tokës

bujqësore dhe pasurive të tjera të paluajtshme

Mbrojtja dhe administrimi i tokës

3. Prodhimi bimor

Drithërat

Perimet

Pemëtaria

4. Prodhimi blegtoral

5. Shërbimi veterinar

6. Industria ushqimore

Agropërpunimi

Kontrolli ushqimor

7. Marketingu

Marketingu dhe politikat tregtare

Marketingu dhe tregtia e inputeve bujqësore

8. Organizimi i fermave dhe kredia rurale

Organizimi i fermave

Kredia dhe financat rurale

9. Zhvillimi rural

10. Kërkimi shkencor

11. Shërbimi këshillimor

12. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve

13. Informacioni statistikor

14. Politikat pyjore dhe mjedisore

15. Peshkimi

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
REFORMA INSTITUCIONALE Shërbimi Këshillimor	- Fuqizimi dhe shtrirja e këtij shërbimi në të gjithë vendin, i lidhur ngushtë me sektorin privat dhe me tendencë drejt privatizimit	- Përfshirja e 10 rretheve të reja në strukturën e Shërbimit Këshillimor Kombëtar - Riorganizimi i strukturës së Shërbimit Këshillimor në: MBU dhe deri në nivel Komune - Rritja e kapacitetit të trajnimit në të gjitha nivelet e Shërbimit Këshillimor - Fuqizimi i lidhjeve midis kërimit dhe shërbimit Këshillimor - Ngritja e një sistemi efektiv monitorimi për Shërbimin Këshillimor	- Krijimi i 5 Qendrave të Shërbimit Këshillimor në rajonet më të rëndësishme bujqësore të vendit me theks rritjen e pavarësisë së tyre - Fuqizimi i shërbimit Këshillimor Publik nëpërmjet medias - Ngritja e një qendre trajnimi gjysëm private për Shërbimin Këshillimor - Fuqizimi i lidhjeve fermer-ekstension-kërkim

ÇËSHTJET		OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
			Afat shkurtër	Afat mesëm
PROBLEMET TOKËS	E	- Krijimi i një tregu funksional të tokës bujqësore dhe pasurive të tjera të palujtshme - Mbrojtja dhe administrimi i tokës	- Përmirësimet ligjore për: - Heqjen e kufizimeve për shitblerjen e tokës - Qiradhënien e tokës - Rregullimin ligjor për tokat e pandara - Procedurat e shitblerjes edhe pa përfunduar regjistrimi i plotë - Miratimi i planit të veprimit për regjistrimin e tokës dhe shtrirja e këtij procesi në të gjithë vendin - Hapja e zyrave të regjistrimit në të gjitha rrethet e vendit - Ngritja e zonës pilot për identifikimin e faktorëve të ndryshëm ndërveprues	Përmirësime në kuadrin ligjor për tregun funksional të tokës bujqësore - Përfundimi i regjistrimit të plotë të tokës dhe pasurive të paluajtshme në të gjithë vendin - Kryerja eurvejimit fushor, përmirësimi dhe përpilimi i hartave dhe librit të parcelave për 1300 zona kadastrale - Përgatitja e akteve ligjore normative për mbështetjen e institucionalizimit të administrimit të tokës në nivel kombëtar

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
PRODHIMI BIMOR DRITHËRAT	- Shtimi sasior dhe cilësor i prodhimit - Përmirësimi i cilësisë dhe zgjerimi i tregut të farërave dhe fidanave - Shtimi i përdorimit të plehrave kimike dhe shfrytëzimi racional i tyre	- Ristrukturimi i shërbimit shtetëror të farërave dhe fuqizimi i prodhimit të farërave nga sektori privat. - Aderimi në ISTA dhe UPOV - Forcimi i tregut privat të inputeve bujqësore - Organizimi i shërbimit të kontrollit të plehrave - Organizimi i trajnimit të specialistëve dhe fermerëve	- Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm për prodhimin dhe marketingun e farës dhe fidanave - Organizimi i sistemit të monitorimit dhe testimi laboratorik i tokave - Dhënia e huave të buta për fermerët
PERIMET	- Zbatimi i teknologjive të reja dhe mekanizmi - Shtimi i sipërfaqes së ujitshme dhe kullimit	- Shtimi i vëllimit të punimeve të mekanizuara, demonstrimi i teknologjive të reja - Zgjerimi i rehabilitimit të kullimit dhe ujitjes me përparësi zonat fushore	- Rritja e investimeve dhe kreditit për mekanizimin e bujqësisë - Rehabilitimi i kullimit dhe ujitjes në nivelin e parareformës
PEMËTARIA	- Prodhimi gjithëvjeter me synim rritjen e eksporteve - Prërtëritja dhe shtimi i sipërfaqes dhe prodhimit në pemë, ullinj e vreshta	- Shtimi i vëllimit të punimeve të mekanizuara, demonstrimi i teknologjive të reja - Zgjerimi i rehabilitimit të kullimit dhe ujitjes me përparësi zonat fushore - 37000 ha ujitje (1998) - 20000 ha kullim (1998) - Përkrahja për ngritjen e serrave familjare kryesisht plastike - Krijimi i 4-5 qendrave private të prodhimit të fidanëve	- Përkrahja për ngritjen e serrave komerciale - Krijimi i qendrave rajonale të prodhimit të fidanave

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
PRODHIMI BLEGTORAL	- Vendorsja e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit blegtoral - Përmirësimi i strukturës së prodhimit blegtoral dhe balancimi i raportit ndërmjet numrit të krerëve dhe prodhimit të ushqimeve për blegtorinë - Organizimi i shërbimit zooteknik dhe veterinar, mbi bazën e qendrave rajonale dhe rrjetit laboratorik të kontrollit	- Mbështetje me legjislacionin e decentralizimit të strukturave të punës racore - Krijimi i tufëzave racore private - Mbështetje me legjislacion për ushqimet e blektorisë - Forcimi i laboratorit të kontrollit të ushqimeve për blegtorinë pranë IKZ-së - Përfundimi i 6 qendrave rajonale (Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Fier, Korçë dhe Shkodër) për inseminimin artificial - Shtrirja e inseminimit artificial në mbi 400 pika të shpërndara në 15-20 rrethe	- Mbështetje me legjislacion e shoqatave të fermerëve për administrimin e punës racore - Mbështetje me kredi për rritjen e prodhimit të mishit dhe vezëve në zonën fushore - Mbështetje me projekte për rritjen e prodhimit nga kullotat në zonën malore - Krijimi i kuadrit ligjor për administrimin, pronësinë dhe mbrojtjen e kullotave - Vendorsja e sistemit dhe të identifikimit të kafshëve, kontrollit dhe informacionit zooteknik në 6 qendra rajonale

CHSH TJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
SHERBIMI VETERINAR	- Kontrolli i sëmundjeve të listës A dhe B dhe të OIE-së - Kontrolli dhe monitorimi i sigurisë ushqimore - Rritja e eksportit të produkteve me origjinë shtazore si burim i madh valute	- Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE - Mbështetja me projekte për kontrollin dhe çrrënjosjen e aftësi epizotike - Krijimi i sistemit të karantinës veterinarë në pikat doganore - Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE - Përfundimi i 2-3 laboratorëve për kontrollin e sigurisë ushqimore në rrethet kryesore të vendit - Mbështetja me projekte për kontrollin veterinar në postat e inspektimit kufitar - Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE	- Mbështetja me projekte për kontrollin dhe çrrënjosjen e murtajës klasike të derrave dhe pseudopestit në shpendë - Kontrolli i sëmundjeve të tuberkulozit, brucelozës dhe plasjes në 6 qendrat rajonale - Zgjerimi i rrjetit laboratorik rajonale për kontrollin e sigurisë ushqimore në 3-4 qendra të tjera rajonale - Monitorimi i inspektimit veterinar të detit Adriatik dhe Jon për hapjen e eksporteve të molusqeve - Mbështetja me projekte për krijimin e hallkave të eksportit të mishit nga bagëtisë e imta

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
INDUSTRIA USHQIMORE	- Mbështetja me legjislacione e sektorit të ushqimit	- Hartimi i akteve ligjore dhe nën-ligjore të ligjit të ushqimit	
AGRO-PËRPUNIMI	- Zhvillimi me prioritet i agrobiznesit privat, për rritjen e standardit të jetesës dhe mirëqenies sociale në Shqipëri	- Privatizimi i plotë i ndërmarrjeve shtetërore ushqimore. - Përcaktimi i rrugëve dhe formave për nxitjen e prodhimit të duhanit, rrushit, qumështit dhe ullirit. Ruajtja e konkurrencës në këta sektorë	- Stimulimi i sektorit privat për prodhimin e produkteve ushqimore nëpërmjet politikave ekonomike
KONTROLLI USHQIMOR	- Hartimi i bilanceve të konsumit ushqimor vjetor (prodhim-import-konsum)	- Hartimi i bilancit vjetor të drithërave të bukës dhe nevojat e importit	- Mbështetja me linja kreditimi
	- Organizimi i një kontrolli ushqimor shtetëror të fortë rigoroz dhe sa më efikas	- Plotësimi i ligjit “Për ushqimin” me akte nënligjore	- Bashkëpunimi për ndërtimin e një sistemi tarifor të tillë, që të stimulojë sigurimin e lëndëve të para, ndihmëse si dhe prodhimin në vend.
	- Përmirësimi i punës në kontrollin ushqimor nëpërmjet fuqizimit të rrjetit laboratorik dhe të analizimit të mallrave ushqimore	- Formulimi i një projekti për ristrukturimin dhe forcimin e administrimit të kontrollit ushqimor	- Hartimi dhe studimi i programeve shumëvjeçare të zhvillimit të industrisë ushqimore
		- Plotësimi me pajisje dhe aparatura i 12 laboratorëve të dëmtuar	- Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të KE-së si parakusht për anëtarësim.
		- Ngritja e të parit laborator rajonal të cilësisë dhe sigurisë në Durrës	- Ngritja e 6 laboratorëve rajonalë, në Shkodër,

			Vlorë, Elbasan, Korçë, Fier etj.
--	--	--	----------------------------------

ËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
MARKETINGU DHE POLITIKAT TREGTARE	Organizimi i tregut për t'u siguruar prodhuesve një aktivitet të arsyeshëm për produktet e tyre, duke marrë parasysh kërkesat e konsumatorit dhe përpunuesve sigurinë dhe cilësinë e produktit. Krijimi i kushteve për mundësi më të mira tregu për prodhuesit në tregjet e brendshme dhe të jashtme.	Përgatitja, paraqitja, ruajtja dhe komercializmi i produkteve bujqësore, duke përmirësuar strukturat e transportit dhe komercializmit në qendrat kryesore të konsumit dhe eksportit. Forcimi i pozitave kontraktuale të prodhuesve në filierën komerciale Dhënia e përgjegjësisë ligjore dhe vendimmarrjes të inspektorateve aktuale (ushqimit, veterinarisë dhe të higjienës) Aderimi në OBT Nëpërmjet shërbimit të ekstensionit të shpërndahet informacioni mbi inputet ekzistuese e ato të reja dhe instruktimi i vazhdueshëm për përdorimin e tyre Realizimi i anëtarësisë në ISTA (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farërave)	Përmirësimi i infrastrukturës tregtare të tregut dhe informacionit tregtar Përfundimi i paketës ligjore të ligjeve dhe rregullave të marketingut Zbatimi i tarifave doganore konform parimeve të OBT-së dhe kontrolli mbi produktet e importuara Përkrahja e shoqatave të prodhuesve nëpërmjet sistemit të kreditit favorizues Mbështetja e sektorit privat nga shteti nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit për farërat, plehrat kimike e kontrollin e tyre si dhe ulja e taksës doganore për inputet e importit.
MARKETINGU DHE TREGTIA E INPUTEVE BUJQËSORE	Forcimi i rolit të tregut të inputeve bujqësore		

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
ORGANIZIMI I FERMAVE KREDIA DHE FINANCAT RURALE	Zbutja e kufizimeve të fermës në funksion të rritjes së të ardhurave të fermerit		
	Rritja e përmasës së fermës dhe ulja e nivelit të fragmentimit	Sigurimi i kushteve teknike për krijimin e tregut të tokës	Sigurimi i kushteve teknike për krijimin e tregut të tokës; nxitja e organizimit të shoqatave të prodhuesve.
	Rritja e nivelit menaxhues të fermerëve	Intensifikimi i informacionit përmes masmediave; kontaktet direkte me fermerët nëpërmjet shërbimit këshillimor	Rritja e kapacitetit të analizës ekonomike të MBU dhe shpërndarja e rezultateve
	Përmirësimi i strukturës së kapitalit fizik për t'iu përshtatur fermave të vogla	Sigurimi i financimeve të huaja me objekt degë prioritare të prodhimit në ferma	Lehtësimi i taksave doganore për importet e kapitaleve të domosdoshme për fermat dhe masat antimonopol në tregun e brendshëm
	Përmirësimi i financimit të fermave		Mbështetja e institucioneve të vetëmbajtura rurale
	Zhvillimi i një sistemi efektiv kredie	Zhvillimi i kredisë së vogël në zona rurale. Krijimi i shoqatave të kreditit	Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm privat të shoqatave të kredisë/kursimeve të zonave rurale

TJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
ZHVILLIMI RURAL	Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rurale Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik i zonave rurale	Riparimi i pas krizës Projektimi i një masterplani në rrjetin e rrugëve (D.P.Rr) Rritja e punësimit nëpërmjet rehabilitimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrive të burimeve lokale.	Investime në infrastrukturën e vogël për të ndihmuar rritjen e sektorit privat Hartimi i programeve të veçanta dhe komplekse social-ekonomike.

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
KËRKIMI SHKENCOR SHËRBIMI KËSHILLIMOR SHËRBIMI I MBROJTJES SË BIMËVE	Institucionet kërkimore-shkencore do të jenë mbështetje e fuqishme e strategjisë së re të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së prodhimit bujqësor e blegtoral Krijimi i një shërbimi këshillimor funksional, publik dhe privat Krijimi i një shërbimi të mbrojtjes së bimëve me standardet fitosanitare ndërkombëtare	Përparësi për kërkim aplikativ Integrimi në sistemin e prodhimit të farnave dhe fidanave Pozicionim aktiv në strukturat e shërbimit këshillimor Asgjësimi i pesticideve stoqe nëpërmjet metodave të përparuara Përmirësimi ligjor në fushën e mbrojtjes së bimëve Ulja e kostos së shpenzimeve të mbrojtjes së bimëve duke rifilluar prodhimin në vend ose formulimin e pesticideve bazë dhe disa biopreparateve	Bashkëpunimi institucional me Universitetin Bujqësor dhe qendrat e tjera kërkimore Krijimi i komitetit të resurseve gjenetike Hapja e 5 qendrave rajonale këshillimore në gjithë vendin Krijimi i strukturave të diferencuara të pesticideve për mbrojtjen e integruar të bimëve Hartimi i rregullores fitosanitare sipas standardeve të BE Rifillimi i prodhimit të pesticideve me bazë bakri dhe sqfuri

SHJTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
INFORMACIONI STATISTIKOR	Përsosja e organizimit të shërbimit të statistikës dhe informacionit për rritjen e saktësisë dhe shpejtësisë të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave	Regjistrimi i pasurive të ekonomive bujqësore Përgatitja e ligjit “Për shërbimin e statistikave dhe informacionit në sistemin e bujqësisë dhe ushqimit” Zgjerimi i numrit të segmenteve për rritjen e saktësisë në informacionin statistikor Organizimi dhe ndërtimi i zgjedhjes së veçantë për bimët e rajonizuara si duhan, patate, ullinj, agrume etj. Konsolidimi i strukturave organizative në të gjitha nivelet e rrjetit të shërbimit statistikor	Zgjerimi i mëtejshëm i numrit të segmenteve për rritjen e saktësisë në informacionin statistikor Përdorimi i internetit në shërbimin statistikor Përsosja e mëtejshme e mbledhjes së të dhënave statistikore nëpërmjet rishikimit e futjes në përdorim të metodave bashkëkohore

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
POLITIKAT PYJORE DHE MJEDISORE	Zhvillimi progresiv dhe shfrytëzimi me kritere të qëndrueshme të pyjeve Rritja e kapaciteteve prodhuese për një sigurim konstant të produkteve drusore dhe jo drusore Politika e mjedisit do të synojë që zhvillimi i bujqësisë të bazohet në parimet ekologjike	Riorganizimi i shërbimit pyjor dhe policisë pyjore Transferimi i rreth 40% i sipërfaqeve pyjore dhe 60% i sipërfaqeve të kullotave në përdorim të komunave. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore - Krijimi i llogarive të të ardhurave për DPPK Hartimi i një kuadri të përshtatshëm legjislativ për mjedisin	Rehabilitimi i ekosistemeve të degraduara (ripyllëzim) të pyjeve Regjistrimi i përgjithshëm i pyjeve dhe kullotave Krijimi i departamentit të menaxhimit të burimeve natyrore në MBU. Stabilizimi i një buxheti për rehabilitimin mjedisor në bujqësi. Krijimi i Komitetit Shtetëror për burime gjenetike dhe Banka Kombëtare Gjenetike e Pyjeve dhe Kullotave

PËRSHKIMI	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	Afat mesëm
	Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe ujërave të brendshme, duke synuar në një rritje graduale të prodhimit peshkor brenda kufijve optimalë të shfrytëzimit racional. Mbështetja e proceseve të ristrukturimit dhe modernizimit të veprimtarive prodhuese, rrjetit të marketingut, industrisë së peshkimit, infrastrukturës portuale dhe veprimtarive ndihmëse e të shërbimit për peshkimin detar për rritjen e prodhimit peshkor dhe të nivelit të punësimit. Zhvillimi me prioritet i akuakulturës në ujërat detare dhe ujërat e brendshme për rritjen e prodhimit, duke pasur në konsideratë ndikimin e mjedisit	Përmirësimet ligjore të ligjit “Për peshkimin dhe akuakulturën” dhe rregulloreve sipas direktivave të KE dhe FAO-s. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të peshkimit Ndërtimi i dy tregjeve të shitjes me shumicë të peshkut (Vlorë dhe Durrës) Ndërtimi i 2 shkallëve për riparimin e anijeve të peshkimit (Shëngjin, Vlorë) Zgjidhja e problemit të eksporteve të prodhimeve të përpunuara me vendet e KE Zbatimi i projektit për studimin e potencialeve të zhvillimit të akuakulturës detare dhe në ujërat e brendshme Realizimi i studimit për lagunat bregdetare për rritjen e prodhimit peshkor të tyre.	Hartimi dhe miratimi i planeve 2- ose 3-vjeçare për menaxhimin e peshkimit në det dhe në ujëra të brendshme Zbatimi në vazhdimësi i projekteve të kërkimit për vlerësimin e resurseve të peshqve detarë (fundore, pellagjike, moluske etj.) Ndërtimi i shkallës për riparimin e anijeve të peshkimit në Sarandë. Plotësimi me pajisje teknologjike dhe informatizimi i tregjeve me shumicë të peshkut (Vlorë dhe Durrës) Përgatitja e studimit për stabilizimin e flotës së peshkimit në Durrës si dhe ngritjen e qendrave të shërbimeve në të gjitha portet. Zbatimi i projektit të investimeve në lagunat bregdetare duke synuar projekte pilot për Nartën, lagunat e Lezhës etj. Nxitja e investimeve private për zhvillimin e akuakulturës detare dhe

			ujërave të ëmbla
--	--	--	------------------

